



Postuar nga Lajmonline: 15:33; 23/10/2014

NË KOSOVË PËR HERË TË PARË KONFERENCA KOMBËTARE E GJUHËS GJERMANE




Organisation/Organizimi:



DEUTSCHZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER



Sponsoren/Sponsorë:



DAAD

KULTUR
kontakt
AUSTRIA

Langenscheidt

Klett

Comelsen

Hueber
Freude an Sprachen

Në Gjumnazin "Loyola", në Prizren me datë 24 dhe 25 tetor do të mbahet Konferenca Kombëtare e mësimitdhënësve të gjuhës gjermane.

Kjo është një konferencë e cila mbahet për çdo vit në Shqipëri, ndërsa për herë të parë këtë vit do të mbahet edhe në Kosovë.

Pjesëmarrës në këtë konferencë janë mësimitdhënës të gjuhës gjermane nga shkolla të ndryshme nga Kosova dhe Shqipëria, profesor universiteti nga Kosova dhe Shqipëria si dhe akter të ndryshëm, të cilët janë të lidhur dhe japin kontribut në mesimin e gjuhës gjermane.

Në këtë konferencë do të marrin pjesë gjithashtu edhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, përfaqësues nga Ambasada Gjermane në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe ambasadorja e re e Gjermanisë në Kosovë, zonja Angelika Viets, e cila është njëra nga vizitoret e shpeshta në "Loyola -Gymnasium".